



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA SEANCA E XI E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira. Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti, më 08.12.2015(e marte) në ora 10,⁰⁰. Në seancë prezantuan 27 anëtarë të Kuvendit. Në seancë ishin prezent kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, organizata joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi Para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si kryetarin e Komunës, nënkryetarin e Komunës, këshilltarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë, kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së X të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Kryesuesi: Para se të kalojmë në punimet e seancës, desha tu njoftoj se zyra ligjore e Ministrisë së Pushtetit Lokal na i ka konfirmua ligjshmërinë e akteve, të cilat kanë dalura nga ky Kuvend, nga seancat e kaluara dhe shfrytëzoj edhe një herë rastin që të ju falënderoj për kontributin e dhënë.

Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës kisha lut këshilltarët: A ka kush ndonjë pyetje apo ndonjë propozim?, fjala është për ju.

z.Bekim Azizi: Kisha pas me fillim dy pyetje, asfaltimet në rrugët rurale, kjo është një kohë e vonë që tash janë duke u bërë, sa jeni të shqetësuar që na u kanë vonuar këto projekte edhe sa do të jenë efektive në këtë kohë, që po e shohë një shqetësim, se nuk është kohë e përshtatshme për asfaltim në këtë kohë. Kish pas një pyetje për drejtoreshën e DKRS-së, e lexova një komunikatë nga klubi Vitia, që kish dhanë dorëheqje drejtoresha: Cilat kanë qenë arsyet që ka dhënë dorëheqje dhe pse janë këto probleme, që në mes të sezonës të ndërpret këtë kontratë me klubin? Dhe ti përsëris dy kërkesat që i kam pasur që një kohë të gjatë, është një dokument që mjetet e zotuarra të vitit 2014 të kanalizimit të Smirës edhe të Terpezes i kanë bartur ato mjete për projektet shtesë, dhe kamë kërkuar një listë të subvencioneve, që ka dhënë Zyra e Kryetarit në vitin 2014, që një vit po e kërkoj nuk ma keni sjell asnjëherë.

z.Sokol Haliti: Pasi që u parashtruan 4 pyetje, faktikisht unë besoj që e mbledhim me një përgjigje shumë të shkurtër. Po e filloj me kulturë, ka qenë sugjerim i kryetarit që drejtoresha mos të jetë e ngarkuar për kulturë më tepër me aktivitete shtesë, për shkaqe që mu nga pozicioi që po flet ti këshilltar ka pasur reagime, që është konflikt interesi. Qëllimi i vetëm i

drejtoreshës ka qenë që ti ngritim klubet tona dhe klubi "Vitia", nën udhëheqjen e ati bordi, tash bënë gara një rang më lart, pra, garon në ligen e parë. Drejtpërsëdrejti e kam ndihmuar edhe unë klubin "Vllaznia" njëjtë, na do të përgatisim që për një kohë të kemi edhe ekip në superligë, prandaj në këtë kuptim është shumë konstruktive kjo, dhe drejtoreshën e falënderoj për ndihmën që ka dhanë, ndihma institucionale do të vazhdoj, ju e dini se para një jave i kemi shpërndarë grandet të projektit bashkëkufitar "kros border", që është quajtur dhe përfitues janë edhe këto dy klubet diku me vlera nga 4 mijë ero, ka edhe shumë klube dhe shoqata që janë përfitues të këtij grandit dhe dihet që Komisioni Evropian është donatorë. Sa i përket rrugëve rurale, janë në përfundim e sipër, është një rrugë në Smirë që do të përfundon tash, po e dini problemin e këtyre pusetave që janë duke u rregulluar, janë rrugë në Germovë, në Sadovinë, janë përfundua në Verban, janë përfunduar në Gushicë, janë përfunduar në Kabash, edhe rruga e "Demirëve" në Pozheran ka përfunduar, këto sene nuk shkojnë me muaj a me kohë po shkojnë me temperaturë dhe dihet se temperaturat për fate të mirë janë optimale dhe po të them se edhe këtë vite komuna i harxhon mjetet maksimalisht, edhe nuk shkojnë mjetet në suficit sikur disa komunave të tjera që kanë edhe miliona humbje, prandaj unë mendoj se në këtë kuptim unë mendoj se edhe në kualitet edhe në kohë jemi shumë në rregull, Vitia kurr ma shumë se këtë vit nuk ka punuar. Për fat të mirë tash në tender ka dal edhe palestra, shpresojmë shumë se nuk do të ketë probleme dhe vitin e ardhshëm do të fillojmë me realizimin e palestrës. Ishte edhe një pyetje tjetër, natyrisht ajo është temë e vjetër, e ke derën qel z.Këshilltar, ne mund të informojmë për të gjitha në mënyrë transparente, pa problem, përndryshe MAPL-në e kemi njoftuar për të gjitha vendimet tona që i kemi marr në përputhshmëri me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale.

znj.Mirlinda Sadiku: Do të kisha si kërkesë për Drejtorin Komunal të Arsimit, që brenda mundësive buxhetore për vitin 2016 të parashihet të bëhet intervenim në shkollën e Skifterajt, prindërit në bashkëpunim ne nxënësit veç e kanë marr një iniciativë, mirëpo nuk besoj se do ta sanoj gjendjen sadopak. Çështja tjetër është aty te shkolla "Januz Zejnullahu", përball është ajo pjesa e mbrojtjes së jetës, e hekurit, është dëmtuar goxha shumë, do të ishte mirë që do të ndërmerri masa, sepse nëse tash bie borë aty ndonjë veturë do të përfundoj edhe në "Moravë".

z.Sejdi Emini: Edhe unë do ti ngriti 3 çështje që lidhen me jetën e qytetarit të komunës së Vitisë. Çështja e parë që do ta ngriti është qentë endacak, janë bë të pa përballueshëm në qendër të qytetit, unë mendoj se duhet me gjetur një formë edhe një zgjidhje patjetër mi eliminuar këta qenë, sepse është ka kanoset edhe jeta, kam dëgjuar se një ditë e kanë kafshuar një fëmijë, e di që me ligj është pak problem, po megjithatë na nuk mundemi mi bë qentë ma të rëndësishëm se njerëzit, duhet me gjet një formulë edhe me bë këtë zgjidhje. Çështja e dytë, kisha kërkuar që në rrugën Pozheran – Viti të vendosen vijat e bardha, sepse tash mjegull dhe në atë rrugë bukur shpesh po ka aksidente dhe më ka rastisë një natë, kur ka pas mjegull, ishte buker problem me marrë drejtim, kështu që momentin që vendosen ato vija besoj se edhe qytetarët kanë me pasur pak ma të letë me qarkulluar, dhe e treta, ndoshta nuk ka të bëjë drejt për se drejti me përgjegjësinë e qeverisë aktuale, po unë mendoj se qeverisja nuk mund mi i ik këtij problemi, sepse është problem që ballafaqohen banoret e Komunës së Vitisë, është një deponi e mbeturinave atje para se të mbërrimë në Gerlicë, po thuaj që është tu bë e pa përballueshme kalimi aty nga era e atyre mbeturinave që kalben, unë mendoj se ne ose si qeverisje ose si kuvend duhet me bë reagime kudoqoftë ose në ministri ose në komunë të Ferizajt edhe me eliminuar atë dhe me largua prej aty.

z.Baki Nebiu: Unë i kam disa shqetësime të banorëve të ndryshëm, një është, rrugët që janë shtruar nëpër fshatra, kapakët e kanalizimeve do janë ndërru do nuk janë ndërru, banoret

pyesin se ku është arsyeja e disa kapakëve që nuk janë ndërru. Tjetra është uzurpimi i pronave shoqërore publike, kjo është një shqetësim i madh, që ju që dy vite nuk intervenuat në asnjë aspekt, sidomos këto nëpër fshatra, uzurpimi po ndodh i madh, ju si inspeksion a keni bënë ndonjë plan ose ndonjë aksion për këtë dukuri negative. Tjetër shqetësim është i banorëve veceja publike, që qëndron këtu mbrapa që dy vite nënë udhëheqjen e juve, ju nuk keni marrë asnjë aksion për funksionalizimin e saj, me të vërtetë gjithë qytetaret që kalojnë kundërmon erë: A e keni ndërmend me funksionalizuar atë WC, a doni ta leni ashtu?. Edhe një shqetësim tjetër është i qytetareve, ku pirja e duhanit nëpër administrata vazhdon të pihet prej punonjësve, aty ju si inspeksion a doni me marr ndonjë aksion si shkelës të ligjit që e bënë vet administrata.

Kryesuesi: Meqë u parashtrua një numër i pyetjeve, ja kisha dhënë fjalën fillimisht kryetarit dhe mandej juve z.Vehbi.

z.Sokol Haliti: Për hirë të korresisë, WC-ja është para nuk është mbrapa, ajo është bënë me vendime të caktuara të institucioneve të ma hershme, të jemi korrekt në këtë kuvend, prandaj ne nuk jemi pastrues të veceve dhe ka mekanizma që merren me këtë temë, ato mekanizma mundemi mi vendos bashkë, është "Eko Higjiena", "Hidromorava", që merren me kanalizime, me ujë e me tjera, prandaj janë këto që duhet me u merr me këtë punë. Dy, duhet me dallu edhe asfaltin prej kanalizimit, prej shakteve, edhe këtu duhet me dallua, p.sh. në Kabash kanalizimi është bënë në vitin 2012, a asfaltin jemi duke e shtruar tash, mirëpo na po detyromi mi ndreqë edhe ato, jemi detyruar të gjitha shaktet, Drejtoria e Shërbimeve Publike mi pastrua në qytet. Bekimi e ngriti kanalizimin e Smirës sërish, kanalizim i shenjt, po kjo mua më takon mi thanë qeveris së kaluar, e tash pse po del në vitin 2016 se nuk e kemi pranuar teknikisht, do të thotë na jemi në përputhshmëri me ligjin, atëherë ta sqaroj edhe një herë për opinionin edhe për këshilltarët, edhe pse e di se një pjesë e tyre janë edhe në rrjedha dhe e dinë shumë mirë, punën nuk e ka krye, nëse nuk e ka krye se ka krye kompania që ju e keni përzgjedh në vitin 2013, e ka lanë në gjysmë dhe nuk keni planifikuar mjete për vitin 2014 fare dhe ne kemi bënë ridestinin me këtë kuvend për me i përfundu nëse nuk i ka krye, për ata nuk e kemi pranuar teknikisht, prandaj të punojmë bashkë në mënyrë që të përfundon edhe mos të shkoj pa kufi ajo qështja e kanalizimit atje, nëse është krejt si po thua ti, unë kisha propozuar, e thirrmi kryetarin e këshillit të fshatit, e thirrmi kompaninë mbikëqyrëse dhe e shikoni a kanë qenë të planifikuar mjetet për një projekt dy vjeçarë dhe tash krejt përpjekjen time për me përfundu ti po don me kthye dhe po ta them haptas se nuk mundesh. Njëjtë ka qenë me shkollën e Sllatines, njëjtë ka qenë me shkollën e Ballances, njëjtë ka qenë me kanalizimin e Terpezës dhe projekte të tjera që mundem me ti radhit 50 dhe borgje të tjera, unë po ju them se në kuadër të këtyre vështirësive jemi ballafaquar shkëlqyeshëm dhe ky vit është viti ma i suksesshëm që i ka ndodhë në 15 vitet e fundit, dhe edhe një herë po ju them, tash në fundvit po kam dëshirë me dal bashkë qosh e në qosh komunës me bënë një vizitë, ta vizitojmë së bashku dhe nëse ka vërejtje edhe ato ti japim bashkë dhe po ju them se me krahasuar me vitin e kaluar ne jemi një hap para. Unë e kam organizuar një takim ku të ftuar keni qenë dy këshilltarët që vini nga Smira, ka qenë administratori i fshatit, ka qenë kompania dhe mbikëqyrësi, po ju nuk keni marr pjesë për me i pa cilat janë defektet, p.sh.: për lagjen e "hoxhovit" është thënë se nuk e kanë lënë, sepse kanë pas kanalizimin paraprak, për lagjen e Naimit kanë pas problem me kojshin, që e kanë përball, etj, janë do detaje që ne mundemi mi tejkalu bashkërisht, me përmbyll projektin me përfundu, por këto bëhen vërtetë gjatë punës bëhen me takime të progresit nëse domi ne me përmbyllur, nëse nuk domi me përmbyll, unë përgjegjësini nuk e kam as minimale në raport me ata që e kanë lënë projektin në gjysmë. Po lidhem edhe me shkollën e Skifterajt, nxemjen në atë shkollë jemi duke e bënë tash, e kemi bënë edhe në Pozheran, kështu që

bashkërisht i kryem punët nëse domi vetëm me thanë e shenjt, atëherë unë them diçka tjetër, unë them se në vitin 2013 në kanalizimin e Smirës mshefet diçka tjetër, edhe një herë po ju them se pi masë lufte Vitia e ka suksesin ma të madhin këtë vit, dhe po ju them se ky sukses nuk është vetëm i imi, është i përbashkët i qeverisë komunale, Kuvendit. Na ka kaluar edhe asfalti i Stublles, projektin e Lubishtes të asfaltit e kemi shtie, Sllatina e ultë mu lidh me Sllatinen e Epërme, po punojmë për Trestenik, dhe unë po ju them se me projekte kemi me përmbyllur krejt dhe me gjithë këto unë mendoj se do ta përmbylim vitin suksesshëm, edhe një herë vlen ftesa që të dalemi së bashku ti shikojmë projektet e realizuara në këtë fund vit.

z.Bekim Azizi: Dy të tretat e kohës po i merr kryetari tu fol. Ti po thu se është vit ma i suksesshëm, po na po themi se është viti ma i dështuar, se po bëhen 3-4 vjet dhe një projekt nuk e ke kryer dhe nëse ti fsheh diçka nga viti 2013 ti je duke bërë shkelje të ligjit, sepse po i fsheh të dhënat, mirëpo kanalizimi i Smirës, na i kemi destinuar, mjetet sa i ke kërkuar i ke marrë paret e ujësjellësit, që janë kanë të parapara të fillojë në vitin 2014, 225 mijë euro i kemi qit në kanalizim, edhe ke pas me krye edhe nuk e ke krye tretuarin e ke prishur, ka shumë lagje që nuk janë të kyçura hiq në rrjetin e kanalizimit dhe nuk kanë mundësi me u kyç as në Terpezë nuk është krye, asfalti në Terpezë tu ka prish krejt, për se dyti je duke e shtruar asfalt, je tu shtrua tash nëpër fshatra kur temperatura është në minus, që nuk lejohet kur bien temperaturat, kur bien nën 8 gradë të shtrohet asfalt, në këto temperatura që je duke e shtruar asfaltin krejt ka me tu prish. Vitin e kaluar ne ti kemi nda ty 300 mijë euro për rrugë rurale, nuk i ke shtruar, e ke prit dhjetorin, është komisioni që i mbikëqyrë, nuk ke nevojë me më thirr mua hajde bëmi marrëveshje qysh me krye kanalizimin, është komisioni, le ta mbikëqyrë, është projekti, le të kryhet puna.

z.Sokol Haliti: Unë nuk mundem absolut me pranuar, se ti po sillesh politikisht, sepse këto janë akuza politike, nuk mundesh me thënë asgjë nuk je duke bërë, tu ka bë shkolla teknike, ne kemi bë emergjencë në Viti, ne kemi bërë park në Pozheran, ambulancë në Pozheran, ne e kemi bë rrugën për Sllatinë, ne kemi bërë edhe hapjen e "Moravës", kështu duke ju kërkuar falje gjithë këshilltarëve dhe ju gjithë të pranishmeve për këtë nivel të diskutimit, unë nuk do ta zgjas më dhe në asnjë pyetje nuk do të diskutoj ma më shumë, por nuk është mirë me bë akuza politike vetëm se ke ti pretendime personale, ato janë çështje të tuat, unë ju kam thanë se duhet me shku përpara në progres dhe kjo i bjen hajde i grami punës, prandaj unë nuk do të flas ma shumë, është nënkryetari këtu, e kam një takim, ju përshëndes të gjithëve.

z.Baki Nebiu" Një këshill kryetarit, se më së miri është që pyetjet e këshilltarëve që po tu parashtrohen ty është mirë me i shënuar, se prej 4 pyetjeve a po përgjigjesh në dy apo vetëm me një, edhe shumë po i ekzagjeron gjërat, pyetje konkrete ke që janë shqetësim i qytetarëve, shqetësimi ishte ky pse nuk janë ndërruar në të gjitha ato rrugë se janë asfaltuar, dhe nëse është veceja banale me përmend këtu, ai është shqetësim i qytetarëve, ajo le të mbetet në ndërgjegjen time kryetar.

z.Bislim Bislimi: Edhe unë gjithashtu iu kisha bashkangjitur shqetësimeve të qytetarëve, më nxiti më tepër edhe ky reagimi për WC-të publike, ma merr mendja që na si popull e kemi tërhjek pastërtinë dhe atë pastërtinë që e kemi obligim shtëpiak e bëjmë me rregull, por këtë shoqëror që e kemi nuk e kemi në rregull, e kjo tregon se kemi një pasqyrë jo të mirë tek të huajt, që nuk jemi ashtu, prandaj duhet të gjendet mënyra ose duhet të paguhet një mirëmbajtës ose fundi i fundit mbylle, edhe pse është bërë aq shumë zhurmë, megjithatë nëse nuk mbahet pastër duhet me u mbyll. Një shqetësim tjetër është, se Komiteti për Komunitete po mban mbledhje jo të rregullta, mirëpo i tregon ato shqetësime të cilat nuk po mirren për bazë, të cilat janë minimale, disa ndihma momentale ose ndihma për dru për disa familje ekstrem në nevojë ose për ndonjë rrugë me zhavorr me shtruar, kështu që ma merr mendja

duhet me iu dhënë pak vullnet që ta dijnë që më të vërtetë jemi të interesuar për ato shqetësime të qytetarëve, por mos të mbetet që vetëm po mbajmë mbledhje. Dhe një tjetër shqetësim e kisha përmendur një rast në Viti ka ndodhur, sepse kur është rregulluar ai pusi te xhamia, atje është bërë një dëm kolateral me të cilin është dëmtuar një qytetar, sepse i ka depërtuar uji në katin përdhese e ai nuk ka qenë këtu dhe ka ardhur është ankuar, se pusi e ka shpuar gypin e kanalizimit të asaj shtëpie, dihet që faji është i kompanisë, megjithatë duhet me iu përgjigj atij qytetari, këto po na vijnë si shkak se nuk po bëjmë plane rregulluese të qytetit, që ta dijmë ku gjendet kanalizimi, uji, rryma e për këtë shqetësohemi si qytetar, si opozitë.

z.Ekrem Abazi: Dashta të bëj pyetje për këshilltarin e kryetarit për arsim: A keni ndonjë rast, që në një shkollë të komunës sonë ka punuar një punëtor i arsimit për një kohë e pas një kohe e keni shpallur konkurs, e pastaj i njëjti ka fituar, edhe pse kanë hy shume në konkurs? Tjetra, në qoftë se në kushte të njëjta ose me fakultet të njëjtë, njëri publik ose shtetëror, tjetri privat, a kanë përparësi ata që e kanë shtetëror dhe a mirret për bazë nota mesatare e atij studenti deri te diplomimi?

z.Daut Xhemajli: Mirë që u biseduan shumë çështje, por pa u shti në rend dite, jam që të bisedohet, por së pari të futen në rend dite, kemi folur edhe për kanalizimin e Smirës, tash na dul i shenjtë, unë kam menduar që vetëm ura është e shenjtë, nuk mendoj ashtu, megjithatë, nëse është problem është çështje e këtij kuvendi me propozuar një komision dhe të analizoj të gjitha faktet dhe argumentet që kanë të bëjnë me këtë punë dhe ia adreson këtij kuvendi. Unë nuk jam me bisedu në mahall e katund, nëse doni të bëni hetim ose si me rregulluar, unë mendoj se në këtë formë mundemi me zgjidh. Ndoshta është shumë e vogël një çështje që e përmendi Baku, por është një shqetësim, kjo puna e WC-së publike. Vitia është ndër komunat e para që ka ndërtuar WC publike, prej atëherë e deri tash kompania që e ka bërë pastrimin e komunës ka pasur të përshkruar saktë mirëmbajtjen e këtyre WC-ve, mirëpo që 5 vite e di që nuk është bërë ajo punë, tash nuk jam në dijeni a e ka të përcaktuar këtë punë, nëse është i njëjti përshkrim kompania që e mirëmban komunën ka obligim ta mirëmbaj edhe WC-në publike, nëse është bërë dëmtim komuna duhet ta sajoj, përndryshe është çështje që nuk duhet të bisedoj.

z.Qahil Sinani: Mirlinda e bëri një pyetje rreth rivitalizimin të shkollave, besoj ka fundi i janarit do të fillojmë të shohim për vitin 2016 ku ka nevojë. Sa i përket pyetjes së Ekremit, shume irreal e ke bërë këtë pyetje, prej vitit 2015 një udhëzim administrativ i MASHT-it i ka bërë të barabartë të gjitha fakultetet si ato publike dhe ato private dhe iu ka dhënë favor atyre që nuk janë të kualifikuar deri në vitin 2017 nuk mundet tui shpallet vendi i punës, por punëtori ka qenë duke punuar, ndërsa ai jashtë nëse iu ka bërë ndonjë e padrejtë le të paraqes ankesë.

z.Samet Idrizi: z.Kryetar, ju e merrni qeverinë dhe e vazhdoni kontinuitetin e qeverisë së kaluar dhe nuk ju liron nga përgjegjësia kur ju e merrni një projekt. Projektit të Smirës i ka kaluar edhe plani dinamik që 1 vit, është dashur momentin që e keni marrur me i lajmëruar me shkrim operatorët, se nëse në afat që e keni të drejtën me ligj nuk i riparojnë dëmet dhe nuk vazhdojnë me kry projektin me ia ndërpre kontratën dhe me kontraktuar një tjetër operator dhe me përfundu punën, kështu veprohet me ligj të prokurimit dhe me ligj mbi ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, edhe kjo duhet të përfundohet, nëse ka vend me bërë denoncime edhe atë duhet me bërë pa asnjë dilemë. E kam edhe një vërejtje, është mirë që janë asfaltuar shumë rrugë nëpër fshatra, lagje, që është një investim i mirë për qytetarë, mirëpo rrugët janë shumë të ngushta, personalisht kam ec nëpër rrugë të Kabashit, janë rrugë shumë të ngushta 3 metra e gjysmë, besoni të dy kerret duhet të dalin jashtë rrugës që me kaluar, edhe vitin e ardhshme do të bëhen shumë asfalte, do të ishte mirë të bëheshin 4 metra nëpër lagje, rrugë dytësore, tretësore.

znj.Majlinda Ostorgllava: Unë kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, këtë çështje e kam ngritur edhe në shumë seanca tjera, ndërtimin e shkollës së Pozheranit. Drejtor, nëse ke dërguar ndonjë kërkesë në ministri të lutem të na japësh një përgjigje, sepse qytetarët e Pozheranit po pyesin vazhdimisht për ndërtimin e shkollës, sepse e dijmë në çfarë gjendje është kjo shkollë.

z.Skender Ahmeti: Unë dashta ti përgjigjem z.Nebiut, sepse bëri dy pyetje, që e preokupojnë edhe qytetarin. Pyetja e parë është uzurpimi i pronave publike, që fatkeqësisht ka shumë e sidomos në fshatin Kabash ka më së shumti në Komunën e Vitisë. Unë jam duke bërë përpjekje të vazhdueshme, që brenda dispozitave ligjore, është rasti i fundit që e kam ndërprerë te Osman Jakupi uzurpimin, kam një kallëzim penal tash së fundi, sepse janë të interesuara edhe organet e tjera për këtë fenomen, i cili po paraqet problem. Kam kërkuar që të identifikohen pronat publike, por paraqet problem, se edhe pas luftës nuk janë zgjidhur këto probleme, sepse bëhet fjalë edhe për uzurpime afatgjata. Pyetja tjetër është për pirjen e duhanit në administratë, është e vërtetë që është duke u pirë duhani në administratë, s'mundem me thënë jo, e di që sa herë shkoj në administratë ose ndonjë inspektor kanë kujdes, por kohën e fundit e kemi pasur një takim në ministri, që janë duke e përgatitur të formularë për gjoba mandatorë dhe kanë autorizim Zyra e Zhvillimit Ekonomik, që t'ia ndalin pagën në vlerë 50 euro dënim. Kjo është forma më e mirë që do ta zbatoj.

z.Ibrahim Rama: Ne kemi bërë një ndarje simbolike për fillimin e punëve në këtë shkollë për vitin 2016, në vlerë 100000, por ndërkohë Ministria e Arsimit e ka inkuadruar në buxhetin 2016-2017. Pra, zgjidhje është bërë dhe ndërtimi do të filloj në vitin 2016.

Kryesuesi: Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë pikë, për këtë seancë kemi paraparë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit të Komunës së Vitisë.
2. Propozim Rregullorë për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe propozim vendimi për shpalljen e diskutimit publik.
3. Draft Rregullorë për dhënien e lejeve mjedisore komunale (LMK) dhe propozim vendimi për shpalljen e diskutimit publik.
4. Propozim vendimi për shpalljen e Zonës ekonomike në kuadër të ZK Budrikë e Epërme.
5. Propozim Vendim për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikimin në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike në zonën kadastrale Budrik e Epërme.
6. Draft Strategjia komunale kundër dhunës në familje 2016-2018.
7. Plani lokal i veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve.
8. Propozim Rregullorja mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor, drejtorëve të shkollave, stafit administrativ dhe teknik si dhe organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi: A ka dikush rreth rendit të ditës?

z.Bislim Bislimi: Ka shumë çështje për të cilat ne si asamblist kemi mendime të ndryshme, por sot dua të propozoj një temë e cila është e përbashkët dhe i tejkalon përmasat e çdo subjekti të veçantë. Më lejoni të ju drejtohem në emër të subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje, AAK dhe NISMA të cilët propozojnë që sot si pikë e parë e rendit të ditës të futet

nxjerrja e një deklaratë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, për të kundërshtuar marrëveshjet për themelimin e “Zajednicës” dhe demarkacionin me Malin e Zi. Ne jemi përfaqësues të popullit dhe kemi obligim të deklarojmë për çdo çështje. Vitia gjithmonë iu është bashkangjitur betejave të mëdha për vendin dhe jam i bindur që edhe sot të gjithë pa dallim do të themi fjalën tonë për të kundërshtuar këto marrëveshje dhe në mbrojtje të vendit. Prandaj i nderuari Kryesues, kërkoj që ky propozim të hudhet në votim për tu futur si pikë e parë e rendit të ditës. Dua të shtoj se nga ky kuvend, jo me këtë përbërje, por të mëparshme, iu është bërë një padrejtësi e madhe komunës së Vitisë dhe i është ndarë territori saj.

z.Daut Xhemajli: Është çështje që është preokupim i të gjithëve, por edhe i qytetarëve. Tash çështja a është ligjore a s’është, komunat kanë të drejtë të bëjnë edhe deklarata, kanë të drejtë të bëjnë edhe vendime. Propozimi sa e kuptova nuk është me bërë vendim, por një deklaram në emër të qytetarëve të Komunës së Vitisë, sepse ky kuvend ka dalur gjithmonë në mbrojtje të kufijve, sepse ka bërë edhe deklarata edhe protestë në Debelldeh. Kjo puna e kundërshtimit për shënimin e vijës kufitare nuk është çështje e jona në kuptimin e ekspertëve, sepse me këtë vendim është copëtuar territori i Kosovës dhe si pasojë e kësaj nuk është e mundur të rrih indiferent. Çështja e bashkësisë së komunave serbe në baza etnike është çështje politike më shumë edhe shumë problematike për të ardhmen e Kosovës dhe rikthimin e Serbisë në Kosovë, duke mos e cenuar sovranitetin dhe integritetin e Kosovës, por duke e rrezikuar funksionimin normal të shtetit të Kosovës, dhe në këtë aspekt unë mendoj që Komunës së Vitisë i takon me deklaruar se është kundër cenimit të territorit dhe kundër bashkësisë së komunave serbe në Kosovë në baza etnike. Çështja tjetër është me e fut në pikë të rendit të ditës dhe me bërë një grup të këshilltarëve dhe me bërë një deklaratë që edhe Komuna e Vitisë është kundër kësaj.

Znj.Mirlinda Sadiku: Ma merr mendja që Kosova dhe krejt populli i saj është sfiduar me këtë situatë politike, sot e kemi një nanë, një motër, një grua e cila për bindje të saj, që Kosovës po i mbillet diçka keq për të ardhmen e saj, është duke e vuajtur paraburgimin prej 30 ditësh, megjithatë ajo çka është e pakta që mundemi me dhënë ne si kontribut është propozimi dhe miratimi i kësaj deklaratë nga ky kuvend. Se sa e ka vuajtur peshën e decentralizimit Vitia e që ia ka bërë aminin Lutfi Haziri kur ka qenë ministër, jemi ne vet dëshmitar. E patë hartën që na e tregoj z.Bislimi, asisoj do të jetë krejt Kosova, 30% territorit. Ne sot po e vulosim edhe me nënshkrim, po ia japim Serbisë. Nuk dua të mbaj ligjëratas as patriotike as morale, as politike, unë e di që kryesues, e di edhe në shpirtin e Hasan Alisë, se thellë diku atje ka shpirti, ka fundi, ia ka trazuar zemrën pikërisht kjo çështje, se unë e di se babagyshi i tij nuk ia ka kthyer pushkën serbit vetëm për këto gjëra. Ne jemi mësuar gjithmonë të bëjmë kompromise të dhimbshme në shpinë të qytetarëve të Kosovës. Të kisha lutur z.kryesues me hy kjo deklaratë në rend të ditës, se përndryshe kjo është e dhimbshme, se ku kemi me i rritur fëmijët tanë.

Z.Hasan Aliu: Unë jam në gjendje me i kuptuar shqetësimet e gjithë këshilltarëve, duke filluar nga propozuesi e deri tek i fundit, por megjithatë njeriu vepron atë sa ka kompetencë, sidomos kur e merr epitetin dhe uniformën e këshilltarit të kuvendit komunal, ti nëse donë me u radhit në radhën e qytetarëve të Komunës së Vitisë dhe zhveshjes nga petku i këshilltarit komunal është diçka tjetër dhe mundesh me qenë kundër atyre dy marrëveshjeve, por megjithatë të gjithë ju keni dhënë një betim në momentin kur jeni zgjedhur si këshilltar dhe ai betim i juaji ju obligon të silleni konformë Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe statutit të komunës. Unë e di demarkacionin në fshatin Debelldeh, dhe në atë kohë asnjë kuvend nuk ka nxjerr deklaratë ta mbrojmë atë territor, ka nxjerr vetëm Vitia. Prandaj, mos ti qesim në taborë të ndryshme, por të veprojmë konform ligjit dhe asaj për të cilën jeni të zgjedhur. Ne këtu nuk jemi duke vepruar si qytetarë, por si këshilltarë, e të tille duhet të veprojmë. Ju kisha lutur që të

sillemi konform funksionit që kemi dhe ai funksion ju thotë të debatojmë për pikat e rendit të ditës, të cilat i kemi, unë nuk dua të bëhem model në rast se dikush e ka shkelur ligjin, unë dua të punoj bashkë me juve në përputhje me ligjin dhe dispozitat e tjera, e për këto tjerat janë organet qendrore. Po e përfundoj me një kërkesë, urdhëroni të veprojmë në kuadër të pikave të rendit të ditës, sepse kjo nuk është kompetencë e Kuvendit Komunal.

z.Daut Xhemajli: Unë e dëgjova nënkryetarin dhe e kam parasysh gjitha zhvillimet politike e tjera, por ky nuk është vendim që duhet me zbatuar domosdoshmërisht dikush, ky është deklarim i këshilltarëve të këtij kuvendi, që i përfaqësojnë qytetarët e kësaj komune, në mënyrë që qeverisja jonë të reflektoj dhe me qenë argument para tyre. Unë po ju tregoj një detaj, Komuna e Vitisë, fillimisht për me u ndarë ka qenë Zhitia, Kllokoti, Mogilla, Podgorci, Vërbovci, Gërqari, Vërnakolla, Vërnezi, Letnica, Shoshare, krejt ai territor ka qenë i pabanuar me serb, ka qenë propozim me qenë komunë serbe. A e dini si është ndryshuar, udhëheqja organeve qendrore s'kanë pasur të bëjnë me këtë punë, neve si institucione kemi marrur si iniciativë, kemi biseduar me priftin e kishës së Letnicës, kisha e Letnicës ka bërë kërkesë që ne nuk mundemi nën juridiksionin e një komune serbe etnike dhe automatikisht është ndryshuar ai vendim. Domethënë zëri i këtyre banorëve dëgjohej përherë. Unë nuk po them që është vendim e duhet patjetër me u zbatuar, por është deklarim i qytetarëve për një vullnet. A kanë nxjerr komunitat tjera deklarata, unë në e di që ka qenë një pjesëmarrje e qytetarëve të rajoneve tjera në protestatat që i kemi organizuar, ne i kemi organizuar si kuvend ato protesta dhe ka reflektuar se është korrigjuar, dhe tash unë dëshiroj që në emër të këtij kuvendi me reflektuar që me u korrigjuar këto gabime. Unë jam që ta bëjmë një deklarim dhe dua që zëri im të dëgjohej dhe nuk dua të pajtohem me disa zhvillime.

z.Ekrem Abazi. E dimë që kompetenca nuk kemi, por nganjëherë dëshira është më e madhe se kompetencat. Besoj që një numër i këshilltarëve dhe qytetarëve të komunës sonë janë me përkrah këtë, dëshira jonë është me përkrah, sepse ne nuk po themi që të marrim vendim, por përkrahje të asaj deklaratë. Unë jam për ta përkrahur këtë deklaratë, e di që nuk ka kurrfarë vlere, por dëshira jonë është me hy në rend dite dhe me u përkrah kjo deklaratë. A është e ligjshme a e paligjshme, të tjerët po e shkelin me dy këmbë.

z.Kryesuesi: Po propozoj që ky propozim të hyn në rend dite dhe të deklarohen. Kush është që të hyn në rend dite, ju lutem? Propozimi hynë në rend dite me shumicën e votave të pjesëmarrësve në kuvend.

Pastaj Rendi i ditës u miratua me këtë pikë plotësuese

U kalua në shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit të Komunës së Vitisë

Kryesuesi hapi debatin lidhur me procesverbalin nga seanca e dhjetë e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

z.Kryesuesi: A ka dikush ndonjë vërejtje në procesverbal. Nëse jo, atëherë kush është që procesverbalin të miratohet. Me votim unanim Kuvendi miratoi procesverbalin nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit.

U kalua në shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës:

2. Propozim Rregullorë për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe propozim vendimi për shpalljen e diskutimit publik

Kryesuesi e ftoi drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm, që ta merr fjalën për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ajet Sallahu: Ju faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Unë në propozim vendim e kam lënë të zbrazët ditën për debatit publik, se nuk e kam ditë agjendën se kur do të mbahet kuvendi. Duhet të lihet një kohë - hapësirë edhe pas mbajtjes së Kuvendit që të bëhet debati publik. Kjo propozim rregullore është dashtë të hartohet si nevojë e kohës pasi komunës tonë i ka munguar një rregullore e tillë. Rregullorja është hartua në harmoni me Ligje dhe Udhëzime administrative. Me këtë rregullore përcaktohen llojet e objekteve të përkohshme, kushtet dhe procedurat për vendosjen, ndërtimi dhe largimi i objekteve në pronë publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes. Plani i vendosjes së objekteve të përkohshme rregullohet në nenin 5 dhe 6 të kësaj propozim rregullore. Kushtet dhe procedurat e vendosjes, ndërtimit dhe largimit të objekteve të përkohshme është paraparë në nenin 7 dhe 8. Vendimi për lejimin e vendosjes, ndërtimit të objektit, pushimi i lejes apo anulimi i lejes është rregulluar me neni 9 dhe 10, ndërsa procedurat e largimit të objektit të karakterit të përkohshëm është paraparë në nenin 11 të kësaj rregullore. Dhënia në shfrytëzim e pronës publike në udhëheqje dhe administrim të komunës është rregulluar me nenet 12, 13 dhe 14. Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj rregullore parashihet në nenin 19 dhe 20, kurse largimi i objektit të përkohshëm parashihet në nenin 21. Dispozitat ndëshkimore janë paraparë në nenin 22 të kësaj propozim rregullore, dhe në fund dispozitat kalimtare dhe të hyrjes në fuqi. Propozim rregulloren drejtorët e kanë marr dhe nëse ka ndonjë pyetje apo paqartësi jam i gatshëm të ju jap sqarime shtesë.

z.Kryesuesi: Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Znj.Vjollca Kadolli – Halili: Përshëndetje për të gjithë! Kjo propozim rregullore do të shkoj në diskutim publik dhe grupi parlamentar i LDK-së do ta jep kontributin në këtë propozim rregullore gjatë shqyrtimit publik. Ne e mbështesim këtë propozim rregullore.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për të gjithë! Këtë propozim rregullore e kemi shqyrtua në Komitetin për Politikë dhe Financa. Rregullorja e rregullon qeshjen e vendosjes ndërtimit dhe largimit të objekteve të përkohshme në pronën publike, mirëpo në KPF i kemi dhënë disa vërejtje, por nuk e vërejtja se janë inkorporu ato vërejtje në këtë propozim rregullore. Ne kishim një vërejtje që të rregullohet çështja që disa persona kanë leje për vendosjen e objektit, por deri më tani nuk i janë përgjigj komunës, nuk i kanë kryer obligimet. Ne kemi propozua që të ju ndërpritet leja dhe të jenë të barabartë me ata që aplikojnë tani. Këtu është fjala për objekte të përkohshme, dhe është dashtë me u inkorporue cilido që ka marr leje prej kësaj komune me vendos objekt të përkohshëm dhe nuk ka veprua konform lejes, nuk ka ndërtuar me material që është përshkrua në leje, duhet ti jepet afat që të rregullohet në pajtime leje ose të largohet. Nuk duhet të tolerohen ata pronar të objekteve që janë ndërtua pa e respektuar lejen dhe vazhdojnë me e shfrytëzua pronën publike. Gjithashtu nuk e vërejtja edhe çështjen e vendosjes së strehëve para lokaleve të cilat po i pengojnë kalimtarët.

z.Kryesuesi: Drejtor, shënoi të gjitha vërejtjet dhe para se të vije për aprovim në kuvend i inkorporon të gjitha propozimet e këshilltarëve.

z.Ajet Sallahu: Vërejtjet të cilat janë bërë në KPF janë inkorporua në propozim rregullore, por pak me vonesë dhe këshilltarët nuk e kanë marr materialin e përmirësuar.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë! Propozim rregullorja e cila është para nesh, për mua është në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë. Rregullorja përcakton llojet e objekteve të përkohshme, kushtet dhe procedurat e objekteve të cilat do të vendosen në pronën publike të Komunës së Vitisë. Pasi që rregullorja do të shkoj në diskutim publik unë nuk kisha me u lëshua më shumë, por duhet të gjithë ta japim kontributin gjatë diskutimit publik që të na del një rregullore e përkryer.

z.Bekim Azizi: Ne i kemi pas dhënë disa vërejtje në KPF. Drejtori po premtun se ato vërejtje janë përmirësua, por nuk janë në propozimin të cilin e kemi marr. Unë prapë e kisha theksua

për antenat e valëve, ti ketë parasysh edhe një herë dhe e përkrahim miratimin e kësaj propozim rregullore që të shkoj në diskutim publik.

z.Bislim Bislimi: Ne mendojmë se këto objekte të përkohshme duhet ti kushtohet më shumë rëndësi largimit të tyre se sa vendosjes së tyre. Si po shihet në këtë propozim rregullore shumë pak kemi lënë hapësirë për me i largua këto objekte të përkohshme. Nëse në bëjmë vendime për me i lejuar këto objekte e nuk mendojmë për largimin e tyre ma merr mendja se qyteti do të mbushet plotë me këto objekte të përkohshme (kioske) dhe do të bëhet si një farë pazari i vogël. Komunitet tjera po punojnë që ti largojnë këto objekte të përkohshme.

z.Ekrem Abazi: Kisha një pyetje për drejtorin: Në qytetin e Vitisë a kemi ndonjë numër, sa objekte të përkohshme duhet të jenë të vendosura në qytet? Mund të ndodhë që të ketë shumë kërkesa, se njerëzit janë të pa punë, kanë nevojë, por duhet me u përcaktua një numër se sa objekte të përkohshme do të lejohen të vendosen. Kam propozim që të caktohet një numër sa objekte do të lejohen të vendosen në qytetin e Vitisë.

z.Kryesuesi: A dëshiron edhe dikush fjalën?, nëse jo, atëherë po e qesim në votim: Kush është që kjo propozim rregullore të shkoj në diskutim publik?

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash u miratua propozim rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronësi publike, që të shkoj në diskutim publik.

U kalua në shqyrtimin e pikës së **tretë** të rendit të ditës.

3. Draft Rregullore për dhënien e lejeve mjedisore komunale (LMK) dhe propozim vendimi për shpalljen e diskutimit publik

z. Kryesuesi: E ftoj prapë drejtorin e Drejtorisë përkatëse që ta merr fjalën dhe ta paraqes një fjalë hyrëse lidhur me këtë propozim rregullore.

z.Ajet Sallahu: Drejtoria për Urbanizëm nuk ka pas një rregullore të tillë dhe kemi fillua, dhe e kemi hartua një propozim rregullore për dhënien e lejeve mjedisore komunale. Rregullorja është hartua, duke u bazuar në nenin 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 5 të Ligjit për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis 03/L-214 dhe në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MMPH-së për dhënien e lejeve mjedisore komunale nr.10/2012 dhe dispozitave të Statutit të Komunës së Vitisë. Qëllimi i kësaj rregullore është parandalimi i ndikimit negativ në mjedis të shkaktuar nga subjektet publike apo private me rastin e realizimit të veprimtarive dhe projekteve përkatëse, të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për identifikim, vlerësim, raportim të ndikimit të projekteve të caktuara në mjedis dhe zhvillimin e procedurave administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e Komunës për lëshimin e LMK, duke siguruar të gjitha të dhënat e rëndësishme lidhur me mjedisin dhe lëshimin e lejes mjedisore. Përkufizimet që përdoren në këtë rregullore janë paraparë në nenin 2 të kësaj rregullore. Aplikimi për leje mjedisore, afati për miratim, detajet e ankesës dhe transferimi i lejes mjedisore komunale është paraparë në nenin 9, 10,11 dhe 12 të kësaj propozim rregullore. Ndërprerja e vlefshmërisë së vendimit për LMK-së është paraparë në nenin 13, dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat kalimtare janë paraparë prej nenit 17 deri në nenin 24 dhe hyrja në fuqi në nenin 25. Është bërë një gabim teknik në fund të propozim rregullores, është neni 26, kurse duhet të jetë neni 25.

z.Kryesuesi: Hapi diskutimin për këtë propozim rregullore.

z.Sami Demelezi: Edhe kjo propozim rregullore e përgatitur nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit, konsideroj se është punuar mirë dhe me përkushtim. Drejtori e theksoi se vërejtjet e bëra në KPF janë inkorporuar, por me vonesë dhe ne nuk i kemi para vetes. Por me që edhe kjo propozim rregullore shkon në diskutim publik, konsideroj se

gjatë debatit publik do të plotësohet. Edhe unë e mbështes që të shkoj në procedurë për debat publik.

z.Sejdi Emini: Unë e di që kjo rregullore i përket Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Për me dhënë leje duhet me kërkuar në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor. Pa dhënë leje ministria ne nuk e di për çka jemi duke fol këtu për këto probleme. Kisha kërkua që ta shqyrtojmë këtë çështje a është kompetencë e Kuvendit Komunal dhe qeverisë komunale apo është kompetencë e Ministrisë e Planifikimit Hapësinor për me dhënë leje, mos ti komplikojmë gjërat dhe mos ti marrim përgjegjësitë të cilat nuk janë tonat. Kisha kërkuar që edhe një herë me u konsultua me ligjin dhe mos me bërë ne rregullore sa për sy e faqe, por të miratojmë rregullore aty ku e lejon ligji.

z.Kryesuesi: Unë po shpresoj që drejtori në momentin kur e ka sjellë para kuvendit një rregullore të tillë e ka mbështetjen në ligj dhe Udhëzimin Administrativ. Drejtori është këtu dhe në fund do të na jep sqarime.

z.Ajet Sallahu: Do të jap një sqarim për këshilltarin, se janë pikat që merret vendimi në Ministri, por kjo është një leje mjedisore komunale dhe është ekskluzivisht në kompetencë të komunës. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis dhe Udhëzimi Administrativ i MMPH-së për dhënien e lejeve mjedisore komunale nr.10/2012 e parasheh kompetencën ekskluzive për dhënien e lejes mjedisore komunale. E keqja e kësaj rregullore është se kjo është dashtë me u nxjerr më herët dhe me punu në bazë të rregullores.

z.Kryesuesi: A dëshiron edhe dikush fjalën? Nëse jo, atëherë po e qesim për miratim që kjo propozim rregullore të shkoj në diskutim publik: Kush është për aprovimin e kësaj propozim rregullore? Me votim unanim u miratua propozim Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore komunale, që të lëshohet në diskutim publik.

U kalua në shqyrtimin e pikës së **katër** të rendit të ditës.

4. Propozim vendimi për shpalljen e Zonës ekonomike në kuadër të ZK Budrikë e Epërme

z.Kryesuesi: E ftoj drejtoreshën e Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi që ta merr fjalën.

znj.Fatbardha Emini: Përshëndetje për të gjithë! Më lejoni që të paraqes arsyetimin e propozim vendimit për shpalljen e Zonës Ekonomike në kuadër të ZK Budrikë e Epërme. Me këtë vendim propozohet që të shpallet zona ekonomike me status "Parku Industrial" në kuadër të Zonës kadastrale në Budrikë. Zona ekonomike me status "Parku Industrial" e definon territorin në parcelën e propozuar 641-1 në vendin e quajtur "Batanica", me kulturë kullosë e klasit të tretë, me sipërfaqe prej 15.50,00 ha në Zonën Kadastrale Budrikë e Epërme, në pronësi të Komunës së Vitisë. Të nderuar anëtar të Kuvendit, më lejoni që të paraqes një arsyshmeri të propozimit të kësaj zone, e cila propozohet të shpallet park industrial. Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm për biznese, krijimi i vendeve të reja punës, ku parashihen të hapen mbi 200 vende të reja pune, rritje të mbështetjes së bizneseve dhe krijimi i kushteve për investime në veprimtari të ndryshme, ku në këtë zonë parashihet të zhvillojnë veprimtarinë e vetë më shumë se 38 biznese, promovimi i investimeve vendore dhe të huaja, krijimi i sektorëve agroindustrial konkurrues në bazë të teknologjisë moderne dhe inovative, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me fokus bujqësinë dhe industrinë e ushqimit etj. Ky propozim është në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal dhe ligjin për zonat ekonomike dhe Udhëzimin administrativ që e rregullon këtë fushë. Në këtë zonë sipas planit ideor që është bërë, parashihet të investohen më shumë se 800.000,00€, ku do të jetë interesi i veçantë për zhvillim të lokaliteteve rreth këtij lokacioni dhe në veçanti për komunën ku parashihet të gjeneroj të hyra më shumë se 10.000€ në vit, do të rritë shkallën e të punësuarve dhe do të

krijoj kushte për investime. Ne si komunë jemi të obliguar të kompletojnë dokumentacionin, si: Vendimin e kuvendit, Planin e Zonës, arsyshmerin dhe dokumentet tjera që parashihen me Udhëzimin Administrativë për Zonat Ekonomike. Investimet do të bëhen nga investitorët, deri më tani kemi aplikua në Komisionin Evropian, MAPL, po ashtu do të aplikojmë edhe në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, e cila është kompetentë për themelimin e Zonave ekonomike. Të nderuar këshilltar, duke pas parasysh interesin e qytetarëve dhe të komunës ju ftojme që ta votoni këtë vendim.

z.Kryesuesi: Hapi diskutimin për këtë propozim vendim.

znj.Mirlinda Sadiku: Në fillim ju përshëndes! Ju drejtoresh thatë se do të hapen 200 vende të reja të punës. Ky është një lajmë mjaft i mirë, por në bazë të çkafit e kë bërë këtë paralogari. Thatë se do të operojnë 38 biznese, dhe të hyrat komunale do të jene 10.000€ brenda vitit. Nëse përpjesëtohet me numrin e bizneseve, atëherë do të del 0.26 kontributi i këtyre bizneseve në buxhetin e komunës. Dëshiroj ta di pse është anulua diskutimi publik që ishte paraparë të mbahet me 19 nëntor, si dhe a keni biseduar me ata qytetarë, cili është reagimi i tyre po ashtu edhe a do të kenë ata përparësi në punësim, se ne të gjithë jemi të gëzuar që hapen vende të reja të punës, mirëpo duke i parë disa fakte të biznesit gjithë andej Kosovës na shprehet një dozë e dyshimit. Ju faleminderit!

z.Bislim Bisimi: Shpallja e zonës ekonomike në këtë ngastër e konsiderojmë vendim të ngutshëm dhe jo të arsyeshëm. Shpallja e zonës ekonomike në këtë lokacion, ku dëmtohet toka bujqësore dhe unë po them se pas ndarjes së Kllokotit, dhe marrjes së resurseve më të rëndësishme, uji temomineral dhe toka më pjellore, caktimi i kësaj toke zonë industriale, ekonominë e Vitisë do ta dëmtoi edhe një herë duke i marr 15 hektar tokë pjellore dhe duke e shndërrua në tokë jo pjellore për nevojat e bizneseve. Ne mendojmë se ky lokacion mund të zëvendësohet më një lokacion tjetër, duke e rregulluar infrastrukturën. Kjo mund të zëvendësohet me një lokacion në kodër të Visoçes, përkaj rrugës Gjilan - Ferizaj. Zgjidhja që po propozohet që të ndërtoj diçka, po prish diçka tjetër, duhet të hiqet njëherë e përgjithmonë nga koka, sepse këto vendime do të kenë pasoja të pa përmirësueshme për gjeneratat që vinë pas. Ne mendojmë se vendimet e tilla nuk mund të merren pa pëlqimin e banorëve të zonës kadastrale. Meraja, që quhet në gjuhën e popullit gjithherë ka qenë në shërbim të atij populli, prandaj kjo duhet të zgjidhet me një debat ku duhet të ftohen edhe subjektet opozitare, në të kundërtën vendimi do të jetë i pa pranueshëm. Komuna e Vitisë nuk duhet në tokën e bukës të ndërtoj zonë ekonomike.

z.Bekim Azizi: Propozimi i zonës ekonomike në Budrikë, ne edhe në KPF kemi dhënë mendimet tona, këtu në rend të parë nuk ka një planë të mirëfilltë se çka parashihet atje të zhvillohet. Nuk kemi një diskutim me qytetarët e kësaj zone kadastrale. Propozimi për zonë ekonomike është bërë për 15.5 hektar, kurse sipas informatave që kemi janë rreth 26 hektar. Ne po i lamë rreth 10 hektar pa i përfshi në zonë ekonomike. Ndoshta kjo pjesë është e uzurpuar apo nuk dihet se çka është me këtë sipërfaqe. Kjo duhet të verifikohet dhe të përfshihet e tëra në zonë ekonomike. Unë do të abstenoj në miratimin e këtij vendimi se më duket më shumë kemi me pas shpenzime se sa dobi me miratimin e këtij vendimi.

z.Ali Bajrami: Ky propozim që është në rend dite është i qëlluar, se: 1. është evidentua një ngastër për parkun industrial, që deri tash ka qenë totalisht e pa shfrytëzuar; 2. Sipërfaqja që është prej 15.5 hektarëve, por nëse është edhe ajo që e tha Bekimi edhe ajo sipërfaqe duhet të kompletohet, por për momentin është sipërfaqja për 15.5 hektar. Në neni 4 po e shoh se është e propozuar veprimtaria prodhuese industriale dhe agropërpunuese, veprimtari tregtare eksport-import etj. Kështu që duke u bazuar në këtë dhe konfiguracionit që gjendet në magjistralen Gjilan - Ferizaj i plotëson të gjitha kushtet për shpalljen e kësaj zone zonë

ekonomike. Komunës i ka munguar hapësira komunale për me zhvillua biznese të cekura në nenin 4 të këtij propozim vendimi. Këtu do të përfiton Komuna e Vitisë dhe lokalitet që gjenden në afërsi të kësaj zone ekonomike. Besoj që kjo iniciativë do të has në përkrahje edhe të qytetarëve të kësaj zone. Qytetarëve ne duhet të ju krijojmë kushte dhe vende të reja të punës dhe përkrahja nuk do të mungoj.

z.Daut Xhemajli: Për mua ka qenë pak e pa qartë apo e pa kuptueshme jo në kuptim të asaj që nuk duhet ti hapet perspektivë zhvillimit ekonomik, por zona – vendi ku është propozuar mu ka duk absurde dhe jo i qëlluar. Problemi është nuk e di si ka mund me qenë e planifikuar edhe në planin zhvillimor zonë ekonomike - industri. Me një vend ku toka është e klasit të tretë, apo mundet me qenë dhe një klasë më e mirë se klasa e tretë (më pjellore). Sa e kam kuptua unë kjo zonë është propozuar se nuk ka pas alternativë me propozu zonë tjetër. Në nenin 4, ku janë definua llojet e veprimtarive, tregtare eksport- import, ajo zonë kishte me qenë mirë me u propozua për veprimtari prodhuese, ndoshta në të ardhmen ndonjë liqe artificial, që Vitisë i kishte shkua për shtati dhe për shërbime të tjera në funksion të saj. Për veprimtari industriale ende nuk jam i bindur se çështja është se Ministria do ta shpallë zonë ekonomike me kusht që me i plotësuar të gjitha kushtet. Unë jam që me u shpall për Zonë industriale por jo për veprimtaritë të cilat janë propozuar në nenin 4. Edhe në KPF kam propozuar me i hy planit zhvillimor me e ndryshua dhe me e gjet ndonjë zonë që është më e përshtatshme dhe të mos ngutemi me marrë vendimin tonë. Mendoj se në vendin ku propozohet si Zonë Industriale nuk do të ketë mundësi me u zhvillua biznesi, sepse është vendi ku është niveli më i ulët i lartësisë mbi detare në at pjesë. Të gjitha predispozitat i ka që ai vend me qenë ndonjë liqe artificial. Unë nuk jam pengesë, por nuk mundem me e miratua një vendim të kësaj natyre.

z.Samet Idrizi: Vendi ku po mendohet me u caktua vend për zonë industriale nuk është i përshtatshëm. Edhe unë nuk e mbështesë dhe besoj se edhe grupi i PDK-së nuk do ta mbështetë këtë propozim vendim.

z.Sami Demelezi: Sa i përket këtij propozim vendimi, unë konsideroj se pas arsyeshëmrisë që e ka dhënë drejtoresha e Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, për shpalljen e zonës ekonomike në Zonën Kadastrale Budrika e Epërme, dhe duke pas parasysh që edhe komuna jonë të ketë një zonë industriale, unë jam pro këtij propozim vendimi, pa marr parasysh se dikush e shëf hijeshinë te liqeni, dikush te diçka tjetër. Unë ndoshta për mua hijeshia më e madhe është aty ku krijohen të ardhura.

z.Kryetari i Komunës: E drejtë e qeverisë komunale është me i bërë vendimet e drejta dhe që janë në interesin e qytetarëve, dhe që i kontribuojnë zhvillimit ekonomik. Alternativat për krijimin e zonave ekonomike në Viti janë të pakta. Ne kemi mendua alternativa: 1) gryka prej Ferizajt kah Dardania 2) lokacioni në Sadovinë, por nuk është paraparë me plani zhvillimor. Ne mund të marrim iniciativë për ndryshimin e planit zhvillimor, por duhet të kaloj një afat prej 5 vite nga dita e aprovimit të planit zhvillimor, dhe 3) vendi ku e kemi propozua për Zonë ekonomike. Kjo zonë ekonomike e ndihmon biznesin nuk e pengon, por edhe kushton rregullimi i lokacionit. Do të vazhdoj rregullimi i lumit Morava dhe nuk do të ketë problem me vërshimin nga uji. Me këtë vendim nuk themelohet zona ekonomike. Ky është vetë një nga dokumentet të cilat duhet të sigurohen - kompletohen për krijimin e Zonës Ekonomike. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e jep vendimin përfundimtar për themelimin e Zonës ekonomike dhe ajo i ndan mjetet.

U kalua në shqyrtimin e pikës së **pestë** të rendit të ditës.

5. Propozim Vendim për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikimin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike në zonën kadastrale Budrik e Epërme

z.Fatbardha Emini: Për shkak të kohës që po na ngutet për me aplikua në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e kemi propozuar për të njëjtën seancë të kuvendit, kemi shkua me këto dy propozim vendime. Është Udhëzimi Administrativ për aplikim i cili në mënyrë të veçantë i rregullon procedurat për aplikim. Me propozimin e kryetarit ne e kemi edhe ekipin apo grupin punuese, po thuaj se një muaj kemi punuar, po është punuar për një zonë tjetër që pikërisht plani zhvillimor komunal na e ka ndalua të aplikojmë me atë zonë që të aplikojmë për Sadovinë të Qerkezëve, edhe pse është hartua edhe projekti për atë zonë. Tash po shkojmë me variantin e dytë. Duhet të shkohet përmes Kuvendit Komunal për me pas mundësi me aplikua në Ministrinë Tregtisë. Me propozim vendim fillohet iniciativa për kryerjen e punëve përgatitore për aplikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike me status “Park Industrial” në njësinë kadastrale nr 641-1. Pastaj rregullohet obligimi i drejtorive komunale dhe në fund organizimi i konsultimit me publikun.

z.Kryesuesi: Hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Pasi askush nuk u paraqit për diskutim, kryesuesi e paraqiti për aprovim Propozim Vendim për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikimin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike në zonën kadastrale Budrik e Epërme. Kuvendi i Komunës me 14 pro, 1 kundër dhe 7 abstenime miratoi Vendim për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikimin në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për marrjen e pëlqimit për themelimin e zonës ekonomike në zonën kadastrale Budrik e Epërme.

U kalua në shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës:

6. Draft Strategjia komunale kundër dhunës në familje 2016-2018

Fjalën hyrëse lidhur me Draft Strategjinë komunale kundër dhunës në familje 2016-2018 e paraqiti zyrtarja për barazi gjinore dhe drejta të njeriut znj. Ibadete Hyseni.

Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Nuredin Lutfiu: Përhëndetje për të gjithë. Më lejoni që ta jap kontributin tim në këtë draft Strategji komunale kundër dhunës në familje 2016-2018, propozoj që në hyrje të shënohet definicioni i dhunës në familje dhe format e kryerjes së saj. Te paragrafi 3, ky dokument synon të jap “ndihmesë” jo, por të shënohet “kontribut” në arritjen e standardeve sa më të larta. Në faqe 6, Qëllimi dhe objektivat strategjik të strategjisë kjo strategjik nuk ka nevojë me qenë por vetëm Qëllimi dhe objektivat e strategjisë. Në faqe 6, te pabarazia gjinore, eliminimi i pabarazisë gjinore dhe dhunës në familje. Unë kisha me qenë krenar nëse Komuna e Vitisë e eliminon dhunën në familje. Këtu duhet të shënohet të zvogëlohet apo parandalohet dhuna në familje, se të eliminohet nuk ka mundësi. Në faqe 7 te analiza e situatës dhe problematika e dhunës në familjen edhe këtu nuk është mirë. Të shënohen faktorët të cilët ndikojnë në dhunën në familje, dhe e shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës nuk ka nevojë me u shënua të shkuarës. Në faqe 8, Problematika sociale lidhur me dhunën në familje. Te divorcet janë disa faktor e jo vetëm dhuna në familje. Në komunën ton shumica e divorceve bëhen për rregullimin e dokumenteve jashtë vendit. Këtu është dashtë të jepen shënime cilat divorce kanë qenë si rezultat i dhunës në familje dhe cilat për shkaqe tjera.

z.Samet Idrizi: Lidhur me Strategjinë kundër dhunës në familje 2016-2018, e kam lexuar, por ka mundësi me u përfshi edhe disa gjana se jo në vitin 2015, por më herët kemi pas raste kur burri ka denoncu rastin në polici, se gruaja ka ushtrua dhunë ndaj burrit. Mendoj se edhe ushtrimin u dhunës së grave ndaj burrave duhet të përfshihet në këtë Strategji.

z.Nënkryetari: Strategjia nuk ka për qëllim mbrojtjen e një gjinie, por e rregullon dhunën në familje pa marr parasysh prej cilës gjini ushtrohet.

z.Daut Xhemajli: Është një rast i mirë për Komunën e Vitisë që me miratimin e kësaj strategjie me i aktivizue mekanizmat që munden me e parandalua dhunën në familje. Dhe dhuna në familje nuk nënkupton vetëm dhunë ndaj grave, por nënkupton dhunë ndaj të moshuarve, fëmijëve etj, kështu që tash e tutje pas miratimit të Strategjisë kemi një adresë, ku krejt këta mekanizma që janë institucional për luftimin e kësaj dukurie me u koordinua për veprimet e tyre sidomos në parandalimin e dhunës në familje. Në fushat tjera janë mekanizmat tjerë (policia, mbrojtësit e viktimave etj). Unë kërkoj që komuna më saktë ta definoj adresën në komunë ku kanë me u koordinua këto aktivitete dhe kërkoj që në institucionet që i mbikëqyr komuna QKMF,QPS, shkolla të bëjë më shumë aktivitete rreth parandalimit të kësaj dukuri.

znj.Ibadete Hyseni: Gjatë fjalës hyrëse unë thash se i mirëpresim të gjitha ato propozime që e plotësojnë këtë strategji. Propozimet të cilat u dhanë nga këshilltari Nuredin Lutfiu, disa propozime do ti marrim, por disa jo. P.sh.: definicioni për dhunën në familje, kjo është Strategji e nuk është rregullore. Në Rregullore duhet të shënohet çka është dhuna në familje. Ne kemi kërkuar nga ju z. këshilltar që të na ndihmoni në hartimin e kësaj draft Strategjie, por ju nuk keni shprehë gatishmëri. Ju faleminderit!

z.Kryesuesi: z.Lutfiu nuk ka qenë anëtar i grupit punues, por kontributin e vetë e dha në kuvend dhe ne e falënderojmë: A dëshiron edhe dikush fjalën? Nëse jo, atëherë po e paraqesim për miratim. Kush është që të miratohet Strategjia kundër dhunës në familje 2016-2018. Për votuan 21 këshilltar dhe 1 abstenim. Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash u miratua Strategjia komunale kundër dhunës në familje 2016-2018.

U kalua në shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës:

7. Plani lokal i veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve

Fjalën hyrëse lidhur më Planin Lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve e paraqiti Përparim Sadiku, Kryetar i Grupit punues për hartimin e Planit Lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve.

z.Përparim sadiku: Më lejoni që si kryesues dhe në emër të grupit punues komunal për hartimin e planit lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve, të paraqes një përmbledhje për përmbajtjen e këtij plani lokal të veprimit. Fillimisht më duhet të cek se ky plan buron nga përgjegjësit që ka Kosova në kuadër të synimit për të integruar në BE, po ashtu edhe Komuna e Vitisë, përkatësisht organet administrative komunale kanë obligimi të nxjerrin Strategji të ndryshme të punës dhe në kuadër të kësaj përgjegjësie ZKKK ka hartuar planin lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve, që ka për qëllim punën trevjeçare përkatësisht periudhën kohore 2016-2018 të institucionit të komunës karshi Riintegrimit të të Riatdhesuarve. Plani lokal i veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve është hartuar nga grupi punues komunal nën rekomandimin dhe bashkëpunimi e MAPL përkatësisht Departamentit për Riintegrim si dhe në përkrahje të plot nga Kryetari i Komunës z. Sokol Haliti. Ky planë është hartuar mbi këto dokumente referenciale, si: Strategjinë nacionale për Riintegrim të personave të Riatdhesuar, Planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar, Rregulloren numër 08/2015 për Rintegrimin e personave të Riatdhesuar, Udhëzuesin për ndihme dhe mbështetje për personat e riatdhesuar për integrim të

qëndrueshëm, Doracakun për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare. Ky plan lokal i veprimit përmban katër objektiva, që në vete këto objektiva kanë aktivitet, masa, tregues të matjeve, afate kohore, dhe institucionet e përfshira. Ne si institucione komunale fillimisht synojmë forcimin e kapaciteteve komunale për Riintegrim, fuqizimin e ZKKK, zgjerimin e komisionit komunal për Riintegrim me akter kuç që kanë të bëjnë me Rriintegrimin e të riatdhesuarve. Fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet ZKKK-së me drejtorit komunale, bashkëpunimin me OJQ- vendore dhe ndërkombëtare komunitetin e tyre. ZKKK-ja përkatësisht Komuna e Vitisë, respektivisht Kryetari i komunës në bashkëpunim dhe me qeverinë dhe akterët tjerë synon integrimin e qëndrueshëm në shoqërinë Vitiase të të Riatdhesuarve nëpërmjet banimit të qëndrueshëm, arsimimit, dhe punësimit etj. Pa dyshim se ky plan ka edhe koston financiare që janë të evidentuara si kosto administrative, kosto nga programi i Riintegrimit dhe Fondet e partnerëve jashtë institucional, që mund të jenë OJQ të ndryshme, fondet e BE-së, komuniteti, mërgata etj. Ju falënderoj për dëgjim dhe kërkoj nga ju që të shfaqni ide rreth begatimit përmbajtjesor të këtij plani me interes për Riintegrimin e të Riatdhesuarve.

Kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Pasi askush nuk u paraqiti për diskutim Kryesuesi e paraqiti për miratim planin lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve. Kuvendi i Komunës me votim unanim miratoi Planin Lokal të veprimit për Riintegrim të të Riatdhesuarve për Komunën e Vitisë.

U kalua në shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës:

8. Propozim Rregullorja mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor, drejtorëve të shkollave, stafit administrativ dhe teknik si dhe organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Vitisë.

Fjalën hyrëse lidhur me propozim Rregulloren mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor, drejtorëve të shkollave, stafit administrativ dhe teknik si dhe organizimin e punës në Institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë e paraqiti Qahil Sinani, drejtor i Drejtorisë për Arsim i Komunës së Vitisë. Kjo propozim rregullore ka qenë në diskutim sidomos në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Vitisë. Rregullorja është përkrahë nga diskutimi publik dhe kërkoj edhe nga ju që ta miratoni.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z.Sejdi Emini: Është e vërtet se kjo rregullore ka qenë në seancën e kaluar, mirëpo ne i kemi dhënë disa vërejtje këtu, mendoj se disa prej tyre janë përmirësua, mirëpo te Këshilli i Shkollës është prapë i njëjti gabim. Ajo çka po më shqetëson, këto janë të rregulluara me ligj dhe tash po rregullohen me rregullore dhe po përzihen. Ligjin e nxjerr Kuvendi i Kosovës, kurse rregulloren e nxjerrin ne si Kuvend komunal. Rregullorja është një rend shtëpiak, kurse ligji është një akt të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës.

z.Bekim Azizi: Kjo është e rregulluar me ligj. Detyrat e punëtorëve të arsimit janë të parapara me kontrata, mirëpo, prapë unë do të angazhohem ta jap një kontribut. P.sh.: te detyrat e sekretarit të shkollës, në shumicën e shkollave sekretarët e shkollave janë ekonomista, sepse janë paraparë që të jenë iniciues të shpenzimeve në shkolla. Shkollat e vogla më pak se 500 nxënës nuk kanë sekretar, kush do ti kryen përgjegjësitë e sekretarit, nuk i janë bart askujt. Kush i ka përgjegjësitë e zëvendës drejtorëve për shkollat që kanë më pak se 1000 nxënës e nuk kanë zëvendës drejtor. Te neni 20 është paraparë nëse punëtori arsimor, i cili brenda një viti shkollor mungon nga puna pa arsye 5 ditë pune, përkatësisht 20 orë mësimi, i ndërpritet kontrata e punës ose nuk i vazhdohet kontrata për vitin vijues, iniciohet procedurë disiplinore. Ndërprerja e punës është e rregulluar me ligj, duhet të respektohet procedura, unë e kam

dhënë vërejtjen edhe në KPF, por nuk qenka përmirësua. Është paraparë gjoha nëse mungon nga kujdestaria e ditës gjatë vikendeve apo gjatë ditëve të festës. Kjo nuk është në rregull, sepse në shkolla nuk e kemi të rregulluar kujdestarinë. Gjithashtu te neni 21, është paraparë se për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset Çerdhja e fëmijëve, duhet të jetë Drejtorja e Çerdhes së Fëmijëve, drejtorët e shkollave etj.

z.Daut Xhemajli: Unë e kam parasysh se kjo rregullore ka qenë në diskutim publik, është shqyrtua në KPF, e kemi kalua edhe në Kuvend, por nuk po mundem me e kuptu ende pse vërejtjet që pranohen, që janë të arsyeshme nuk përfillen, duke pas parasysh se po duhet përsëri me i përsërit, kjo nuk ka kuptim. Edhe te Drejtorja e Urbanizmit nuk janë përfillë vërejtjet e paraqitura në KPF. Te kjo rregullore të gjitha afatet kanë kaluar, është dasht zyrtari i drejtorisë me i pas parasysh të gjitha propozimet që janë me peshë dhe janë të arsyeshme të përmirësohen dhe të na vjen një rregullore e përmirësuar. Nuk i ka dhënë rëndësi dhe nuk është rregulluar zgjedhja e Këshillin të Prindërve të DKA-së. Në nivel të shkollës është në rregull, por në nivel të DKA-së jo. Sipas një Udhëzimi Administrativ nr.28/2012, DKA-ja ka Këshill të Prindërve. Edhe delegimi i anëtarëve në Këshillit të Prindërve në DKA, duhet me qenë e rregulluar me këtë rregullore. Edhe vërejtjen të cilën e paraqiti këshilltari Bekimi, kjo duhet me u rregullu ndryshe. Ai që nuk vjen në punë mbi 5 ditë pune duhet të rregullohet se fillon procedura disiplinore dhe Komisioni disiplinor ia ndërprejnë marrëdhënien e punës. Te neni 18 nuk është shumë e qartë mekanizmi i ndarjes së mjeteve financiare, që i ndahen secilit institucion. Ky nen nuk ka pas venë në këtë rregullore.

z.Kryesuesi: A dëshiron edhe dikush të diskutoj lidhur me këtë propozim rregullore. Nëse jo, drejtor mbetet obligim i juaji që brenda dy dite ti inkorporoni të gjitha vërejtjet që u paraqiten, dhe janë të pranueshme, dhe janë në pajtim me Ligjin mbi Arsimin. Kush është që rregullorja të miratohet me vërejtjet të cilat u dhanë. Me votat e të gjithë të pranishmëve u miratua Rregullorja mbi përshkrimin e detyrave të punës të punëtorëve arsimor, drejtorëve të shkollave, stafit administrativ dhe teknik si dhe organizimin e punës në Institucionet edukativo arsimore në Komunën e Vitisë.

U kalua në shqyrtimin e pikës plotësuese të rendit të ditës:

9. Deklarimi i Kuvendit të Komunës së Vitisë kundër marrëveshjet për caktimin e vijës kufitare me Malin e Zi dhe marrëveshjes për krijimin e bashkësisë së Komunave me shumicë serbe në Republikën e Kosovës “zajednices”

z.Nënkryetari: Me propozimin e këshilltarëve komunal të disa subjekteve politike arrijmë që ta fusim edhe një pikë plotësuese të rendit të ditës. Duke mos dëshirua ta ngulfasim demokracinë rreth diskutimeve dhe ti japi shembull nivelit qendror se si duhet debatuar dhe diskutuar edhe ata në nivelin qendror u fut në rend ditë një deklaratë. E ftoj dikend që ta lexoi tekstin e deklaratës.

z.Daut Xhemajli: Pasi nuk patëm mundësi me të gjithë përfaqëuesit e grupeve me takua ne e bënë një version dhe ua shpërndamë grupeve ose këshilltarëve në përgjithësi. Secili prej tyre me e dhënë mendimin ose vlerësimin e tyre. Teksti i deklaratës është kështu: "Kuvendi i Komunës së Vitisë, duke shprehë shqetësimin e qytetarëve të Komunës së Vitisë lidhur me marrëveshjet për caktimin e vijës kufitare me Malin e Zi dhe marrëveshjes për krijimin e bashkësisë së Komunave serbe në Republikën e Kosovës “zajednices”, të cilat e cenojnë tërësinë territoriale të Kosovës sovranitetin dhe integritetin e saj, në mbledhjen e mbajtur më 8.12.2015 nxjerr këtë deklaratë:

Duke ditur se Kosova me marrëveshjen për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi do të humbë mbi 8.229 km, duke ditur se krijimi i kësaj bashkësie, “zajednices” si e tillë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi. Krijimi i “zajednices”

e zhvesh shtetin e Kosovës nga përkufizimi si shtet i pavarur, sovran e demokratik, unik dhe i pa ndashëm. Krijimi i “ zajednices” ka për qëllim ndarjen mbi baza etnike etj....”

z.Kryesuesi hapi diskutimin.

z.Samet Idrizi: Kërkoj falje se në matematik nuk kam qenë më i miri, por nuk është fjala 8.229 km², por është fjala për 8 km apo 8.229 hektar. Krejt Kosova i ka afër 10.000 km². Kërkoj që të korrigohet teksti se nuk është mirë të del kështu në media. Kjo nuk është në kompetencë të komunave, por kompetencë e nivelit qendror. Grupi i PDK-së do të jetë neutral gjatë votimit të kësaj deklarate. Ndoshta me shumë peshë do të kishte me dal një deklaratë partiake se sa e Kuvendit, sepse këto dy çështje nuk janë në kompetencë të kuvendit komunal.

znj.Vjollca Kadolli – Halili: Edhe në dëshiroj të theksoj se kjo nuk është në kompetencë të nivelit komunal dhe ne si grup parlamentar nuk jemi ftu gjatë hartimit të tekstit të deklaratës. Sikur të ishim ftu unë kisha propozu për tekstin e deklaratës, që Kuvendi i Komunës së Vitisë propozon që deputetet e Kuvendit të Kosovës ti kthehen debatit në parlament, se aty duhet të zhvillohet debati, e jo në nivel lokal. Realisht se unë nuk janë kudër që partitë e kanë kërkuar të miratohet kjo deklaratë, por shumë po folët me emocione, unë jam shumë e sigurt se nuk ka gjak shqiptari që e përkrah shënimin e vijës kufitare nëse humbet territori i Kosovës ose nëse krijimi i asociacionit të komunave është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Kjo nuk duhet të vendoset në nivel lokal, por duhet të vendoset në Parlamentin e Kosovës. Unë kisha propozuar që mos të hidhet fare në votim miratimi i kësaj deklarate.

z.Bislim Bislimi: Ne kemi vuajt shumë si shqiptar. Vendimet të cilat janë marr për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi dhe krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe janë në kundërshtim interesat e Kosovës dhe me Kushtetutën e Kosovës.

z.Kryesuesi: Unë në fillim thash se po e futim në rend të ditës përhirë të mos ngulfatjes së demokracisë, sepse jemi të gjithë të vetëdijshëm se kjo çështje nuk është në kompetencë të nivelit lokal, por e nivelit qendror: A dëshiron edhe dikush fjalën? Nëse jo, po e qesim për miratim propozimin për miratimin e deklaratës për kundërshtimin e caktimit të vijës kufitare me Malin e Zi dhe krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosove. Prezent në sallë janë 23 këshilltar: Kush është për miratimin e deklaratës? Pro votuan 9 këshilltar, kundër 10 këshilltar dhe 4 këshilltar abstenuan.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi deklaratën e propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit i falënderoj anëtarët e Kuvendit për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të Kuvendit dhe e shpalli të mbyllur këtë mbledhje ne ora 14⁴⁵.

Procesmbajtës:

Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë

z.Naim Pira
